

L I G J
Nr. 8693, datë 23.11.2000

PËR RATIFIKIMIN E “AMENDAMENTIT TË KONVENTËS FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE - ITALI PËR FINANCIMIN E PËRBËRËSVE TË ASISTENCËS TEKNIKE PËR NDËRMARRJEN E UJËRAVE DHE TË NDËRHYRJEVE INFRASTRUKTURE NË RRJETIN HIDRIK, NË KUADËR TË PROJEKTIT TË REHABILITIMIT TË RRJETIT HIDRIK TË TIRANËS”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Amendamenti i Konventës Financiare ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale - Itali për financimin e përbërësve të asistencës teknike për ndërmarrjen e ujërave dhe të ndërhyrjeve infrastrukturore në rrjetin hidrik, në kuadër të projektit të rehabilitimit të rrjetit hidrik të Tiranës”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2818, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

AMENDAMENTI NR.1

NË KONVENTËN FINANCIARE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE MEDIOCREDITO CENTRALE – ITALI PËR 53 200 000 000 (PESËDHJETË E TRE MILIARDË E DYQIND MILIONË) LIRA ITALIANE, FIRMOSUR MË 11 MAJ 2000

Nenit 1 të Konventës i shtohen pikat 1.5 dhe 1.6 si vijon:

“1.5 Kontratat në lidhje me projektin e përmendur në pikën 1.2 më lart do të trajtohen sipas procedurave të përzgjedhjes së Bankës Botërore për prokurimin e shërbimeve, të punimeve dhe mallrave, duke mbajtur parasysh specifikën e kredisë italiane.

1.6 Përqindja e “përgjashtimit” e pranuar për secilën nga kontratat e pikës më sipër, fiksohet në maksimumin 35 % (tridhjetë e pesë për qind) të vlerës së vetë kontratës.”

PËR MEDICREDITO CENTRALE – ITALI

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Romë, 22.9.2000

Ministri i Financave